

VENDIM
Nr. 104, datë 26.6.2019

PËR NJË NDRYSHIM NË VENDIMIN E BORDIT TË ERE-s NR. 181, DATË 10.11.2017, “PËR MIRATIMIN E RREGULLORES PËR KRITERET STANDARTE TË CILËSISË SË SHËRBIMIT TË SHPËRNDARJES SË ENERGJISË ELEKTRIKE”, TË NDRYSHUAR

Në mbështetje të nenit 7, pika 1 dhe nenit 16, të ligjit nr. 43/2015 “Për sektorin e energjisë elektrike” i ndryshuar; nenit 104, pika 4, germa “a”; nenit 113, pikat 1 dhe 3, e ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurës Administrative”, si dhe nenit 15 të “Rregullores së organizimit, funksionimit dhe procedurave të ERE-s”, bordi i ERE-s në mbledhjen e tij të datës 26.6.2019, mbasi shqyrtoi relacionin e përgatitur nga drejtoritë teknike për një ndryshim në vendimin e bordit të ERE-s nr. 181, datë 10.11.2017, “Për miratimin e rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të ndryshuar,

konstatoi se:

- Me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, bordi i ERE-s vendosi miratimin e rregullores për: “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- Në vijim të kësaj vendimmarrje me kërkesë të shoqërisë OSHEE sh.a., si rezultat i pamundësisë për të përmbushur kërkesat e kësaj rregulloreje brenda afateve që ajo përcakton, në lidhje me realizimin e investimeve të domosdoshme, bordi i ERE-s, me vendimin nr. 271, datë 21.12.2018, vendosi shtyrjen e afateve të përcaktuara në rregulloren për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike”.

- OSHEE sh.a., me shkresën nr. 13173 prot., datë 14.6.2019, protokolluar në ERE me nr. 400/1, datë 17.6.2019, në përgjigje të shkresës së ERE-s me nr. 400 prot., datë 13.6.2019, me anë të së cilës iu rikujtua shoqërisë përfundimi i afateve, ka përcjellë tabelën për “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike të plotësuar nga OSHEE sh.a. dhe analizën e treguesve të performancës së rrjetit shpërndarës për vitin 2018, si dhe krahasimin e realizimit të treguesve në vitet 2017–2018.

- OSHEE sh.a., duke mos qenë e përgatitur për vënien në zbatim të afateve të përcaktuara në këtë rregullore për shkak se gjatë kësaj periudhe ka kryer analiza më të detajuara për përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuar nga rregullorja për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike, për periudhën 2017–2018, si dhe nisur nga kushtet e vështira financiare të shkaktuara nga situata hidrologjike, OSHEE sh.a. ka rishikuar programin e zhvillimit ekonomik në funksion të ndryshimeve të këtyre efekteve financiare, si të tillë implementimi i projekteve që lidhet me performancën e kompanisë është i kushtëzuar me realizimin në kohë të investimeve.

- Në këto kushte OSHEE sh.a. kërkon aplikimin në mënyrë të përshkallëzuar për të miratuar nivelin e lejuar të kriterëve standarde të performancës në zona të ndryshme, duke e rivlerësuar në funksion të performancës së ushtruar gjatë periudhës tranzitore dhe gjendjes së sektorit të shpërndarjes së energjisë elektrike për sa me poshtë:

- Zona: Tiranë–Durrës, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2021;

- Zona: Vlorë–Elbasan–Fier, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2022;

- Zona: Gjirokastër–Berat–Korçë, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2023;

- Zona: Shkodër–Burrë–Kukës, afati i kërkuar - brenda datës 31.12.2024.

- Duke e parë në syrin e investimeve të parashikuara nga OSHEE sh.a. vërehet përqendrim i konsiderueshëm i investimeve që ndikojnë në përmirësimin e parametrave të vazhdueshmërisë së furnizimit me energji elektrike. Në analizat e deritanishme që deklarohen nga OSHEE sh.a., merren në konsideratë vlerat e parametrave vetëm në tension të “lartë” dhe të “mesëm” kështu që llogaritja

e parametrave të vazhdueshmërisë së furnizimit duhet të shtrihet edhe në tension të “ulët” e si rrjedhim shtyrja e kërkuar nga OSHEE-ja mund të konsiderohet e domosdoshme.

- Duke shqyrtuar sa më sipër cituar nga shoqëria OSHEE sh.a. dhe duke evidentuar pamundësinë e realizimit të investimeve të domosdoshme, gjykojmë që kërkesa për shtyrjen e afateve është pjesërisht e arsyeshme për realizimin e parametrave të kërkuar nga “Kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të shpërndarjes së energjisë elektrike” pasi më parë shoqëria duhet të paraqesë në ERE një studim të detajuar mbi përshkallëzimin e realizimit të parametrave të kërkuara sipas zonave të sipërcituara dhe të propozojë nivelet e lejuara të cilësisë së shërbimit siç është përcaktuar në rregullore.

Për gjithë sa më sipër cituar, bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Pikat 7.1, 7.2 dhe 10.2, të “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin nr. 181, datë 10.11.2017, të bordit të ERE-s”, të pezullohen deri në miratimin nga ERE-s të niveleve të lejuara të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, sipas pikës 7.4 të po kësaj rregulloreje.

2. Pika 7.3 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ndryshon dhe bëhet: “OSHEE sh.a. do të propozojë në ERE për miratim, nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit, brenda datës 30 shtator 2019”.

3. Pika 7.4 e “Rregullores për kriteret standarde të cilësisë së shërbimit të furnizimit dhe performancës së sigurisë së rrjetit të shpërndarjes së energjisë elektrike, ndryshon dhe bëhet: “Brenda 12 muajve nga paraqitja e propozimit të OSHEE sh.a., ERE-ja do të vlerësojë nivelet e pritshme të performancës dhe do të miratojë nivelin e lejuar të kriterëve standarde të cilësisë së shërbimit”.

4. Drejtoria Juridike dhe e Mbrojtjes së Konsumatorit do të njoftojë OSHEE sh.a. lidhur me vendimin e bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

Për këtë vendim mund të kërkohet rishikim brenda 7 ditëve kalendarike, si dhe mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti